




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT KORRIK DHE ÇRREGULLIMET E INFORMACIONIT

Korrik, 2023



PËRMBAJTJA

| | | |
|----------|--|----|
| 1 | PËRMBLEDHJA..... | 3 |
| 2 | METODOLOGJIA..... | 5 |
| 3 | TË GJETURAT KRYESORE..... | 6 |
| 4 | SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE | 8 |
| 5 | SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE..... | 11 |
| 6 | GJUHA MIZOGJENE DHE DHUNA ONLINE NDAJ GRAVE NE POLITIKE | 13 |

MEDIA MONITORING AND INFORMATION DISORDERS DURING JULY

1 Koha e monitorimit

1 – 31 korrik 2023

2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube dhe Instagram.

3 Mostra

Gjuhën shqipe dhe serbe

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i crregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit korrik në Kosovë.

Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbëlueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.

1.PËRMBLEDHJA

IGjatë muajit korrik 2023, Instituti D4D ka bërë monitorimin e mediave online dhe rrjeteve sociale në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe janë analizuar 1500 artikuj me përmbajtje të çrregullimeve të informacionit në gjuhën shqipe dhe serbe. Gjatë periudhës monitoruese, Instituti D4D ka gjetur se temat me çrregullime të informacionit që kanë dominuar kanë qenë: tensionet në komunat me shumicë serbe në Kosovë, publikimi i përgjimeve të Kryetares së Grupit Parlamentar të LVV-së Mimoza Kusari-Lila, si dhe përleshja fizike e deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Gjatë këtij muaji, Instituti D4D ka monitoruar dhe analizuar në mënyrë aktive ngjarjet e përshkruara më poshtë, në artikujt e mediave dhe portaleve online në gjuhën shqipe dhe serbe.

Një nga zhvillimet kryesore gjatë kësaj periudhe ka qenë përdorimi i inteligjencës artificiale për të krijuar video me përmbajtje të pavërtetë duke përdorur zërin dhe pamjet e personaliteteve të ndryshme politike, apo ndryshe të njohura si ‘deepfake’[1]. Së fundmi është përdorur inteligjenca artificiale ku janë targetuar figurave të rëndësishme politike për të gjeneruar audio-biseda të pavërteta duke përdorur çështje sensitive për të nxitur reagime me gjuhë të urrejtjes dhe duke tensionuar edhe më shumë raportet ndër-etnike në Kosovë.

Krahas zhvillimeve në komunat me shumicë Serbe, e, ndër temat më të shumti çrregullime të informacionit gjatë muajit korrik në mostrën e monitorimit në gjuhën shqipe, kanë qenë zhvillimet politike në Kuvendin e Kosovës, përfshirë rrahjen e deputetëve në Kuvend, ngjarje e cila ka nxitur dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes duke forcuar kështu edhe më shumë ndasitë politike.

Ngjarjet në këto katër komuna në veri të Kosovës gjatë monitorimit janë mbuluar më shumë nga mediat në gjuhën serbe krahasuar me mediat në gjuhën shqipe, sa i përket përmbajtjeve me çrregullim të informacionit.




Fig. 1.1 Mbulueshmëria e artikujve në gjuhën shqipe

[1] Korshunov, P., & Marcel, S. (2018). Deepfakes: a new threat to face recognition? assessment and detection.arXiv:1812.08685.

Dy ngjarjet që kanë dominuar me më së shumti artikuj me përmbajtje të çrregullimeve të informacionit në ambientin medial në Kosovë kanë qenë:

- Polarizimi politik, në mostrën në gjuhën shqipe nw kwtw kategori tw lajmeve janë prodhuar 52,781 artikuj. Instiuti D4D ka analizuar 1500 artikuj, ku prej tyre kanë rezultuar 50 artikujt me përmbajtje të çrregullimit të informacionit.

- Zhvillimet në veri të Kosovës, në mostrën në gjuhën shqipe janë prodhuar 30,438 artikuj, ku prej tyre janë analizuar 1500 artikuj ndërsa 50 artikuj prej tyre me përmbajtje të çrregullimit të informacionit.

Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe temat që kanë dominuar gjatë muajit korrik, sipas platformës së monitorimit kanë qenë; Dialogu Kosovë-Serbi, si dhe ngjarjet rreth zgjedhjeve të parakoshme në komunat me shumicë Serbe në Kosovë. Tre temat që kanë dominuar me artikuj me çrregullime të informacionit gjatë muajit korriksipas kësaj platforme kanë qenë:

- Zhvillimet në veri të Kosovës - Në mostrën në gjuhën serbe janë prodhuar 6,763 artikuj ku prej tyre janë analizuar 1500 artikuj dhe kanë rezultuar mbi 30 artikuj me çrregullim të informacionit.

- Ndikimi nga Jashtë – Në këtë kategori të lajmeve në mostrën në gjuhën serbe janë prodhuar 4, 377 artikuj ku janë analizuar 100 artikuj prej të cilëve mbi 10 artikuj kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

- Dialogu Kosovë – Serbi – Në këtë kategori, në mostrën në gjuhën serbe, brenda muajit korrik janë prodhuar 17, 283 artikuj, ku prej tyre janë analizuar 1500 artikuj prej të cilave 50 me përmbajtje të çrregullimit të informacionit.




Fig. 1.2. Coverage of articles in Serbian

2. METODOLOGJIA

Për të identifikuar çrregullimet e informacionit Instituti D4D ka përdorur Platformën Pikasa, duke klasifikuar artikujt sipas kategorive të përcaktuara në bazë të lajmeve kryesore përgjatë muajit korrik. Raporti monitorues i mediave online dhe rrjeteve sociale përmban një përmbledhje të hulumtimit dhe analizës së çrregullimeve të informacionit përgjatë muajit korrik 2023. Gjatë këtij muaji, Instituti D4D ka monitoruar dhe analizuar në mënyrë aktive ngjarjet e përshkruara më poshtë, në artikujt e mediave dhe portaleve online në Kosovë dhe Serbi.

Mostra e analizës përbëhet nga artikujt në gjuhën shqipe dhe serbe, të cilët përbëjnë çrregullim të informacionit. Monitorimi gjatë muajit korrik tregon se dinamika e ngjarjeve gjatë këtij muaji ka qenë e fokusuar në zhvillimet e ndërlidhura rreth zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës. Për këtë periudhë një mujore prej gjashtë kategorive që janë monitoruar: Zhvillimet në veri të Kosovës, Ndikimet nga Jashtë, Dhuna Online ndaj Grave (Mizogjinia), Zhvillimet Politike, Gjuha e urrejtjes, kanë dominuar në mostrën e gjuhës shqipe kategori: Zhvillimet në Veri të Kosovës dhe Polarizimi Politik.

3.TË GJETURAT KRYESORE

- Artikuj me përmbajtje të çrregullimeve të informacionit që nxisin tensione politike dhe konflikt ndër-etnik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishin prezente përgjatë muajit korrik. Pas vendosjes së katër kryetarëve të komunave në veri të Kosovës, liderët politikë, gazetarët dhe opinionistët nga Kosova dhe Serbia kanë qenë të përfshirë në narrativa nacionaliste dhe përçarëse që promovojnë urrejtjen ndër-etnike.
- Artikuj me përmbajtje Deepfake[1] kanë filluar të kenë prezencë më të theksuar në platformat e mediave sociale në Kosovë. Meqenëse përmbajtja "deepfake" e gjeneruar nga Inteligjenca Artificiale (AI) është bërë më e sofistikuar, "deepfake" janë bërë tashmë një formë shqetësuese e dezinformimit në mediat sociale, duke targetuar figura të njohura politike. Një audio me përmbajtje të pavërtetë e cila është postuar në rrjetet sociale ku dëgjohet një bisedë e gjeneruar në mes të ambasadorit të SHBA-së Jeffery Hovenier në Kosovë dhe kryeministrit Albin Kurti u shpërnda dhe u diskutua gjerësisht në media. Kjo bëri që Ambasada e SHBA-së në Prishtinë të dal me një reagim dhe të ngris shqetësimet rreth formave të reja të dezinformimit.
- Politikanët e Kosovës, veçanërisht gratë në politikë, kanë qenë target i dhunës online dhe komenteve misogjene përmes meme[2] dhe artikuj që përmbanin gjuhë nxitëse. Gratë politike ishin veçanërisht në shënjestër për deepfake, dezinformata dhe gjuhë mizogjene. Gjithashtu, gratë politike janë kërcënuar edhe me dhunë fizike për pikëpamjet e tyre politike gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë.
- D4D ka identifikuar një rritje të raportimeve me përmbajtje të titujve sensacional apo 'clickbait' në titujt e përdorur nga portalet online në lidhje me ngjarjet në Kuvendin e Kosovës.
- Polarizimi politik, përdorimi i gjuhës ofenduese dhe gjuhës së urrejtjes gjatë periudhë monitoruese kanë qenë prezent. Instituti D4D ka gjetur artikuj me përmbajtje të gjuhës ofenduese të përdorur nga politikanë drejtuar njëri-tjetrit me epitete të ndryshme duke nxitur gjuhë ofenduese dhe ndasi edhe më të thella politike në Kosovë. Raportime me elemente të nxitjes ndëretnike - shumë portale online në gjuhën serbe gjatë zgjedhjeve në katër komunat në veri të Kosovës kanë shpërndarë informacione të paverifikuara gjatë situatës së tensionuar në komunat me shumicë serbe, duke kontribuar kështu në ndasi më të thella ndër-etnike, gjuhë të urrejtjes, panik dhe pasiguripantik dhe pasiguri tek qytetarët.

[1] Deepfake është video e një personi në të cilën fytyra, zëri ose trupi i tij është ndryshuar në mënyrë dixhitale në mënyrë që të duken si dikush tjetër, i përdorur zakonisht me qëllim të keq ose për të përhapur informacion të pavërtetë. Source: Oxford dictionary

[2] Imazh, video, pjesë teksti, etj., me natyrë tipike humoristike, që kopjohet dhe përhapet me shpejtësi nga përdoruesit e internetit, shpesh me ndryshime të vogla. Source: Oxford dictionary

[[1] Deepfake është video e një personi në të cilën fytyra, zëri ose trupi i tij është ndryshuar në mënyrë dixhitale në mënyrë që të duken si dikush tjetër, i përdorur zakonisht me qëllim të keq ose për të përhapur informacion të pavërtetë. Source: Oxford dictionary


[1] Imazh, video, pjesë teksti, etj., me natyrë tipike humoristike, që kopjohet dhe përhapet me shpejtësi nga përdoruesit e internetit, shpesh me ndryshime të vogla. Source: Oxford dictionary

4. SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE

Shembujt në gjuhën shqipe të crregullimit të informacionit që kanë qarkulluar gjatë muajit korrik në mediat dhe portalet online në Kosovë. Përzgjedhja e këtyre artikujve është bërë në mesin e 50 artikujve më të lexuar sipas platformës përmes të cilës është bërë monitorimi i mediave dhe portaleve online.

S'ka më polici në veri pa KFOR-in e EULEX-in (VIDEO)

nga - 14.07.2023 22:15



Portali i lajmeve, Klan Kosova ka publikuar një artikull me titull: “S’ka më polici në veri pa KFOR-in e EULEX-in (VIDEO)”, Ky artikull ka përmbajtje të pavërtetë në titullin e saj. Sipas titullit të artikullit thuhet që nuk do të ketë prezencë të policisë në veri të Kosovës. Nderkaq, brenda artikullit gjendet komunikata zyrtare e Qeverisë së Kosovës ku më saktësisht flitet për zvogëlim të prezencës së Policisë së Kosovës, dhe jo mos-prezencë të saj në veri.

Kjo deklaratë është bazuar në Komunikatën e Qeverisë së Kosovës pas një takimi në mes të Zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi dhe përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčák, që është mbajtur me 10 korrik. Mirëpo pas verifikimit duke iu referuar komunikatës së njëjtë, portali i lajmeve nuk e ka interpretuar me saktësi komunikatën e Qeverisë së Kosovës, ku thuhet se: “Policia e Kosovës bashkë me EULEX-in dhe KFOR-in, sipas nevojës do të vlerësojnë gjendjen e sigurisë, në veçanti për të shikuar mundësinë për zvogëlim të mëtejshëm të prezencës policore në dhe rreth ndërtesave komunale”. Ky artikull ka arritur të marrë 438 ndërveprime duke përfshirë 191 pëlqime, 227 komente dhe 20 shpërndarje.

NATO refuzon Albin Kurtin: Partner jo i besueshëm, rrezikuar jetën e ushtarëve tanë

17/03/2023 10:31 / 14:02

TEMA



Portali i lajmeve, Tema ka publikuar një artikull me titull: **“NATO refuzon Albin Kurtin: Partner jo i besueshëm, rrezikuar jetën e ushtarëve tanë”** duke pretenduar se zëvendësekreteri i NATO-s, Thomas Goffus, gjatë takimit me Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin, e ka konsideruar Kosovën si partner joefektiv për sigurinë, duke vlerësuar gjithashtu se po rrezikon jetën e ushtarëve të NATO-s.

Pas verifikimit të fakteve është vërtetuar se artikulli i publikuar në portalet online, ka pasaktësi në titull dhe nuk ka raportuar saktë deklaratën e zëvendës sekretarit të NATO-s, Thomas Goffus. Në komunikatën e publikuar nga NATO, Goffus është shprehur se: “Bashkëpunimi në kohë dhe kuptimplotë është i një rëndësie kyçe, siç e kam theksuar edhe në takimet e mia të sotme. Bashkëpunimi efektiv është mënyra se si Kosova demonstroi se mund të jetë një partner efektiv i sigurisë për NATO-n”. Ky artikull ka arritur të marrë 56 ndërveprime duke përfshirë 34 pëlqime, 21 komente dhe 1 shpërndarje.

Më 26 qershor 2023, është publikuar një audio-regjistrim i pavartetë ‘deepfake’ në Twitter, tashme platforma e njohur si X, ku prezantohet një bisedë mes Kryeministrit Kurti dhe Ambasadorit Amerikan në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier. Audio regjistrimi u fokusua në diskutimet lidhur me arrestimin e serbëve në Kosovë. Një bisedë e tillë nuk ka ndodhur në mes Kryeministrit Kurti dhe Ambasadorit Hovenier. Tweet-i origjinal tani ka arritur më shumë se 150,000 shikime. Titulli i postimit në Twitter lexon **“Duhet të dëgjohet! KURTI ka regjistruar në një bisedë me të ashtuquajturin ambasadorin amerikan në Prishtinë, Hovenier: “Arrestojmë Serbët në veri dhe nuk na intereson nëse janë kriminelë apo përgjegjës për dhunën apo jo, ne do të vazhdojmë t’i arrestojmë ata...”**



Tweet-i, që përmban audion e rrejshme të Hovenier dhe Kurtit, mori 140 retweet dhe 245 pëlqime, shumica e të cilave vijnë nga llogari anonime dhe imituese në Twitter. [Linku i Tweet deepfake.](#)

Kurti: Mërgim Lushtaku më shau nanën

Autori: Gazeta10



Portali i lajmeve, Kanal10 ka publikuar një artikull me titull: **“Kurti: Mërgim Lushtaku më shau nanën”**, duke lënë të nënkuptohet që është deklaratë e Kryeministrit Albin Kurti, derisa në përmbajtje të lajmit bëhet fjalë për deputeten e Lëvizjes Vetëvendosje, Tinka Kurti. Duke mos e saktësuar personin deklarues në titull dhe vendosjen e fotografisë ka bërë që ky lajm të shpërndalet si 'clickbait'. Ky artikull ka arritur të marr 415 ndërveprime duke përfshirë 128 pëlqime, 286 komente dhe 1 shpërndarje.

Portali i lajmeve, Kanal10 ka publikuar një artikull me titull: **“Shpërthen Matoshi ndaj Kurtit: I paskrupullt, rrenc, budallë e idiot.”** Përdorimi i gjuhës ofenduese ndaj Kryesministrit Albin Kurti ka ardhur si rrjedhojë e ngjarjeve që kanë ndodhur në katër komunat në veri të Kosovës dhe masat që i janë vendosur Kosovës nga Bashkimi Evropian. Ky artikull ka arritur 1,034 ndërveprime duke përfshirë 385 pëlqime, 642 komente.

Shpërthen Matoshi ndaj Kurtit: I paskrupullt, rrenc, budallë e idiot

Autori: Gazeta10



LAJME

Petkoviqi e quan “ekstremist” Sveçlën, pasi tha se është kundër planeve shoviniste të Serbisë



Portali i lajmeve, Gazeta Express ka publikuar një artikull me titull: “Petkoviqi e quan “ekstremist” Sveçlën, pasi tha se është kundër planeve shoviniste të Serbisë”. Bazuar në deklaratën e Petkoviqit, fjala ekstremistë nuk përmendet.

Në deklaratën e tij thuhet: “Qëllimi i vetëm i përpjekjeve obsesive të Sveçlës për të kriminalizuar serbët nga veriu i Kosovës është të justifikojë praninë e paligjshme të njësisive të tij parapolicore në veri të Kosovës, ku ata terrorizojnë popullin serb ditë e natë. Duke folur për krimin, do të ishte mirë që Sveçla të largohet nga vetja dhe nga aktakuzat që janë ngritur me vite ndaj tij për sulmin me gurë ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por edhe për përmbysjen e veturës së misionit të EULEX-it”. Duke u bazuar në titulli, portali i lajmeve nuk e ka interpretuar me saktësi deklaratën e tij, në deklaratën e tij nuk është përmendur fjala ‘ekstremist’. Ky artikull ka arritur të marrë 85 ndërvprime, 49 komente dhe 35 shpërndarje.

5. GJUHA MIZOGJENE DHE DHUNA ONLINE NDAJ GRAVE NE POLITIKE

ortali i lajmeve Gazeta Blic, ka publikuar artikullin: **“Limaj për presidenten Osmani: Kukull për gjynah e patericë e Qeverisë Kurti”**.

Limaj për presidenten Osmanin: Kukull për gjynah e patericë e Qeverisë Kurti



Përdorimi i gjuhës fyese ndaj Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani kanë ardhur si rrjedhojë e ngjarjeve në katër komunat në veri të Kosovës, ku kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj thotë se: “Si një kukull për gjynah si, një patericë e kësaj Qeverie si një. Unë e di që një pjesë e madhe kështu do t'i largohen Albin Kurtit kur ta shohin që po fundoset do të bëjnë përpjekje që të mbahen, të grithen kështu e shoh Osmanin, por jo në shërbim të vendit. Rolin e presidentes, kryeministrit, kryetarit të kuvendit e shoh në raport me vendin, qëndrimin e tyre në raport më të vërteten ndaj vendit, jo me të huaj”.

Duke u bazuar në deklartën dhe gjuhën e përdorur nga Limaj, artikulli pasqyrohet me përmbajtje të gjuhës ofenduese ndaj presidentes Osmani. Ky artikull ka arritur 255 nderveprime duke përfshirë 102 pëlqime, 112 komente dhe 41 shpërndarje.

Videot Deepfake janë shpërndarë gjithashtu në platforma të tjera të mediave sociale si Facebook dhe TikTok. Një video e manipuluar dhe e pavërtetë është shfaqur në TikTok që përshkruan deputeten Mimoza Kusari-Lila, kryetare e grupit parlamentar të LVV-së dhe Slavko Simić, anëtar i Kryesisë së Listës Srpska, duke kënduar së bashku në serbisht.



Kjo video, e cila tani ka më shumë se 20,700 shikime, është shpërndarë gjatë një periudhe kur Kuvendi i Kosovës u angazhua në diskutime lidhur me disa incizime mes Kusarit dhe Simiqit, regjistrime të cilat mediat i kishin bërë publike. [Linku i Tweet.](#)



Pas përleshjeve fizike që ndodhën në Kuvendin e Kosovës, një postim shqetësues është shpërndarë në platformën sociale TikTok nga një përdorues i Twitter-it ku përfshihej imazhi gjeneruar i deputetes Adriana Matoshi duke mbajtur një tabelë, e cila ka marrë më shumë se 2000 shikime dhe komente negative. Imazhi u manipulua për të përfshirë një deklaratë seksiste dhe raciste që thotë: **"Dua një burrë me ngjyrë"**. Përdorimi i gjuhës së tillë fyese tenton të shënjestrojë deputeten Matoshi bazuar në zgjedhjet e saj personale, duke iu referuar drejtpërdrejt marrëdhënieve të Matoshit në të kaluarën, të cilat më parë kanë marrë një mbulim të gjerë mediatik në mediat kosovare.

Deputetja Matoshi ka qenë shpesh objektivi i dhunës online në internet duke komentuar zgjedhjet personale të saj

6. SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE

Shembujt në gjuhën serbe të çrregullimit të informacionit që kanë qarkulluar gjatë muajit korrik në mediat dhe portalet online. Përzgjedhja e këtyre artikujve është bërë në mesin e 50 artikujve më të lexuar sipas platformës përmes të cilës është bërë monitorimi i mediave dhe portaleve online.



Titulli: “Vuçiq: Serbia e gatshme të ruaj/mbrojë jetën e popullit tonë”

Portali i partise politike “SNS” ka publikuar artikullin me titull: **“Vuçiq: Serbia e gatshme të ruaj/mbrojë jetën e popullit tonë”** duke iu referuar ngjarjeve në veri të Kosovës, dhe tentimeve për de-esklam të situatës. Lajme të tilla gjatë gjithë periudhës së muajit korrik kanë mbizotruar ambientin mediatik në Serbi, duke tentuar ti mbajnë të frikësuar popullin se ajo çfarë po ndodhë, duke ju referuar ngjarjeve në katër komunat veriore, mbi protestat dhe prezencën e Policisë së Kosovës pranë komunave, do të sjellte luftë. Deklaratat e Vucicit gjate ngjarjeve ne veri te Kosoves kane nxitur pasiguri dhe frike.

Vucic ka komentuar mbi situaten e tensionuar ne komunat me shumice serbe dhe le hapshire per te nenkuptuar se Serbia mund te filloje nje luftime me Kosoven per te mbrojtur popullin serb..Ky artikull ka arritur 1,908 ndërveprime, prej tyre 1,742 pëlqime 36 komente si dhe 130 shpërndarje.

“Portali i lajmeve “AlfaPlam”, ka publikuar artikullin me titull: “Idetë e Kurtit janë katastrofale dhe gjenocidale”.Këto pretendime kanë ardhur nga Milan Vucevic udhëheqës i Partia Progresive Serbe. E gjithë kjo lidhet me deklaratën e deputetës në parlamentin britanez, Alicia Kearns, që ka paraqitur dëshmi mbi përfshirjen e kishës ortodokse serbe në trafikim të armëve në Kosovë. Në këtë deklaratë poashtu hipotetizohet se një Shqiptar në Shtërpc ka dëshmi se si do të arrestohen serbët, dhe deklaroi se në bazë të këtyre fjalëve mbi 20 familje serbe janë larguar nga Kosova.



“Idetë e Kurtit janë katastrofale dhe gjenocidale”

E gjithë këto i mvesh te Kryeministri Albin Kurti dhe thotë se prapa tyre qëndron po i njeiti me këto ide të cilat janë ‘katastrofale’ dhe ‘gjenocidale’. Ky lajm ka 1,762 ndërveprime, prej tyre 1,607 pëlqime, 19 komente dhe 136 shpërndarje.

DIREKTOR Kancelarije za Kosovo i Metohiju Petar Petković poručio je danas da premijeru privremenih prištinskih institucija Aljbinu Kurtiju, dok je predsednik Aleksandar Vučić na čelu Srbije, neće poći za rukom da jednostranim akcijama protera Srbe sa severa KiM i pokuša da promeni etničku strukturu u četiri srpske opštine.



Titulli: Për gjakun e serbëve të pafajshëm askush nuk është përgjigjur, dhe se deri sa në krye të Serbisë të jetë Vuçiqi, Kurti nuk do të mund ti dëboj serbët nga Kosova”

“Portali i lajmeve, “Novosti”, ka publikuar artikullin me titull: “Për gjakun e serbëve të pafajshëm askush nuk është përgjigjur, dhe se deri sa në krye të Serbisë të jetë Vuçiqi, Kurti nuk do të mund ti dëboj serbët nga Kosova”. Ky lajm me narracion pezhorativ dhe tendencë krijimi frike e paniku, është postuar nga ky portal duke iu referuar deklaratave të Petar Petkovic, ku sipas tij Kryeministri Kurti po tenton të ndryshoj strukturën etnike në katër komunat veriore të Kosovës, dhe të dëboj serbët nga Kosova, duke iu referuar ngjarjeve pas zgjedhore, arrestimeve dhe tensioneve të ngritura pas zgjedhjeve në këto komuna.

ThePo ashtu në tekst shkruhet se “terroristët shqiptar” janë duke u fshehur pas uniformave të Policisë së Kosovës. Ky lajm ka 206 ndërveprime, prej tyre 1 pëlqim, 12 komente dhe 193 shpërndarje.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cilamerr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efektive, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikatspecifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi viziton faqen tonë elektronike:

www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:



659(496.51)(047)

Media monitoring and information disorders during July / Demokraci për zhvillim. -
Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2023. - 17 f. : ilustr. 28 cm.

ISBN 978-9951-823-46-3

ISBN 978-9951-823-45-6

